



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7802 Prot.

Roskovec, më 01, 10 2024

VENDIM

Nr. 58 datë 30/09/2024

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT LIDHUR MIDIS  
BASHKISË ROSKOVEC DHE AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS ME  
NR.7456 PROT DATË 19.08.2024 TË BASHKISË ROSKOVEC, NR. 10813 PROT  
DATË 10.09.2024 TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të nenit 3, 8, 9, 10, 54 shkronja "k", Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Kushtetutës së RSH, Kodit Civil të RSH, Ligji Nr. 111/2018 "Për Kadastrën", Ligji Nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligji Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligjit Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, VKM Nr. 435 datë 26.06.2014 "Për një shtesë në Vendimin Nr. 867 datë 10.12.2024 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur midis Bashkisë Roskovec dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me Nr.7456 prot datë 19.08.2024 të Bashkisë Roskovec dhe Nr. 10813 prot datë 10.09.2024 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës" për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR  
Afrim Plaka

